

**Ideologjia dhe leksiku në tekstet mësimore të Gjuhës shqipe para vitit 1990**  
(Rast studimi: *Gjuha shqipe V*)

**Abstrakt**

Ky punim trajton paraqitjen kontekstuale dhe ideologjike të leksikut në tekstet mësimore të gjuhës shqipe para vitit 1990, vit që shënoi rënien e regjimit komunist dhe tranzicionin drejt një sistemi demokratik në Shqipëri. Ideologjia komuniste e asaj periudhe ndikoi jo vetëm në sistemin politik dhe shoqëror, por edhe në strukturën dhe përmbajtjen e arsimit.

Në fokus të trajtesës është analizimi i *leksikut të ideologjizuar*, i cili përfshin fjalë që transmetonin norma dhe mesazhe politike e sociale të diktuar nga sistemi komunist. Ai dëshmohet përmes një vështrimi krahasues të teksteve të gjuhës shqipe para dhe pas vitit '90, duke vëzhguar sa ka ndikuar sistemi politik e ndryshimet shoqërore në leksikun e gjuhës shqipe në përgjithësi e si lëndë bazë shkollore në veçanti, gjithashtu si ka evoluar e ndryshuar struktura semantike e disa fjalëve.

Janë për zgjedhur si rast studimi tekstet “*Gjuhë shqipe V*” (1973-1984) dhe “*Gjuhë shqipe V*” (2003 e 2022), si niveli i shkollimit që ndan Arsimin Fillor nga Arsimi 9-vjeçar. Objekt analize pas hulumtimit të tyre u bënë disa grupime fjalësh: fjalë të cilat në tekstet e pas '90-ës përdoren në një kontekst e kuptim tjetër nga ai i para 90-ës; fjalë që përdoren me të njëjtin kuptim në të dyja periudhat, por që paraqiten me shembuj të politizuar (në periudhën e parë); fjalë që kanë dalë nga përdorimi së bashku me realien dhe si rezultat nuk janë të pranishme në tekstet e gjuhës shqipe pas '90-ës; fjalë që ndryshuan strukturën kuptimore, me reduktim a shtim të kuptimeve.

Rezultatet e studimit tregojnë se tekstet mësimore të para '90-ës ishin një mjet i fuqishëm propagandistik, ku leksiku jo vetëm përçonte njohuri gjuhësore, por njëkohësisht ndihmonte në formësimin e një identiteti ideologjik të përshtatshëm me doktrinën komuniste. Pas '90-ës, sistemi arsimor shqiptar u çideologjizua, u depolitizuan programet dhe tekstet mësimore, duke u pasuruar me dije shkencore e didaktike bashkëkohore. Kjo frymë e kohës ndikoi dukshëm në leksikun e teksteve të gjuhës shqipe, me të cilat fëmijët shqiptarë mësojnë në shkollë.

Punimi, si një këndvështrim mbi marrëdhënien midis gjuhës dhe ideologjisë, kontribuon në studimet mbi historinë e arsimit dhe ndikimin e tij në shoqëri.

Fjalë kyçe: *fjalë, kontekst, kuptim, ideologji, çideologjizim, politizim, depolitizim*

## Abstract

### **The ideology and vocabulary in Albanian language textbooks before 1990**

(Study case: *Albanian Language V*)

This paper addresses the contextual and ideological representation of vocabulary in Albanian language textbooks before 1990, the year that marked the fall of the communist regime and the transition to a democratic system in Albania. The communist ideology of that period influenced not only the political and social system but also the structure and content of education.

The focus of the paper is the analysis of ideologized vocabulary, which includes words that conveyed political and social norms and messages dictated by the communist system. This is demonstrated through a comparative examination of Albanian language textbooks before and after 1990, observing how the political system and social changes have impacted the vocabulary of the Albanian language in general, and as a core school subject in particular, as well as how the semantic structure of some words has evolved and changed.

The texts “Gjuhë shqipe V” (1973-1984) and “Gjuhë shqipe V” (2003 and 2022) have been selected as case studies, as they represent the educational level that separates Primary Education from Nine-Year Education. After their examination, several word groupings were analyzed: words that in the post-90s texts are used in a different context and meaning from those before the 90s; words that are used with the same meaning in both periods but are presented with politicized examples (in the first period); words that have fallen out of use alongside the reality and as a result are absent from the Albanian language textbooks after the 90s; and words that changed their meaning structure, either through the reduction or addition of meanings.

The study’s results show that the pre-90s textbooks were a powerful propaganda tool, where vocabulary not only conveyed linguistic knowledge but also simultaneously helped shape an ideological identity suitable for the communist doctrine. After 1990, the Albanian education system became de-ideologized, educational programs and textbooks were depoliticized, and were enriched with contemporary scientific and didactic knowledge. This spirit of the times significantly influenced the vocabulary of Albanian language textbooks, which Albanian children use in schools.

The paper, as a perspective on the relationship between language and ideology, contributes to studies on the history of education and its impact on society.

Keywords: *words, context, meaning, ideology, ideologizing, politicization, depoliticization*

## Ideologjia dhe leksiku në tekstet mësimore të Gjuhës shqipe para vitit 1990 (Rast studimi: *Gjuha shqipe V*)

Periodha e komunizmit në Shqipëri karakterizohej nga një sistem ideologjik që ndikoi thellësisht në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, politike dhe kulturore. Ky ndikim përfshinte edhe fushën e arsimit dhe sidomos tekstet e gjuhës shqipe, të cilat reflektonin ideologjinë zyrtare në përmbajtjen dhe strukturën e tyre leksikore. Leksiku i mveshur me ngjyrimin e egër komunist të kohës, i përhapur nëpër tekste mësimore, ishte mjete përmes të cilit synohej formësimi i ndërjegjes kombëtare dhe politike të brezave të rinj.

Siç dihet, gjuha jo vetëm pasqyron strukturat e mendimit dhe të kulturës, por ka edhe forcë ndikuese. Kështu, në Shqipërinë e para viteve '90, gjuha shërbente si një mjet i rëndësishëm për përhapjen e mesazheve politike, ku fjalët dhe shprehjet e ideologjizuara, si mjete propagandistike për të përçarur ide dhe qëllime, i shërbenin kauzës së komunizmit.

Në këtë trajtesë synohet të analizohet një grup fjalësh të ideologjizuara që gjenden në tekstet mësimore, duke i sjellë ato në përfaqje kontekstuale mes dy periudhave historike, para e pas vitit '90. Ndaj, në fokus të këtij studimi janë fjalë dhe shprehje që bartnin ngarkesa politike në tekstet e kohës së regjimit totalitar në Shqipëri, ku fjalori dhe diskursi ishte i orientuar nga përhapja e ideologjisë komuniste dhe mbrojtja e parimeve të saj. Shkolla kishte për qëllim edukimin dhe formimin e nxënësve në këtë frymë, duke ndikuar deri në lëndët e mirëfillta shkencore, siç është *gjuha shqipe*.

Me ndryshimin e sistemit politik dhe hapjen e Shqipërisë *pas vitit '90*, shumë fjalë a kuptime të tyre pësuan transformim, duke u liruar nga ngarkesat ideologjike të kohës. Përmbajtja dhe stili gjuhësor i teksteve shkollore pësoi një ndryshim të rëndësishëm, duke reflektuar një frymë neutrale dhe të përshtatur me realitetet e reja. Filluan kështu përpjekjet për të reformuar sistemin arsimor, duke sjellë ndryshime të mëdha së pari në programet mësimore e më pas në tekste. Ndaj, ky punim përqendrohet në përdorime fjalësh në dy kontekste të ndryshme historike, me ndryshimet e tyre semantike në pasqyrimin e vlerave kombëtare, kulturore dhe shoqërore përmes teksteve mësimore gjuhësore.

\* \* \*

Gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, konteksti politik u reflektua ndjeshëm në leksikon e përmbajtjen e teksteve mësimore të gjuhës shqipe. Programi arsimor kishte për qëllim edukimin ideologjik të fëmijëve që në moshë të re, ndaj, këto tekste ishin të ngarkuara me mesazhe politike. Për të evidentuar një ndikim të tillë në rrafsh leksikor, objekt vëzhgimi kemi bërë *tekste*

të gjuhës shqipe të klasës së pestë të viteve 1973<sup>1</sup>, 1977<sup>2</sup>, 1979<sup>3</sup>, 1980<sup>4</sup>, 1984<sup>5</sup>, në përfaqje me tekste të së njëjtës klasë të viteve 2003<sup>6</sup> e 2022<sup>7</sup>.

Gjatë punës sonë hulumtuese mbi leksikon e përdorur në këto tekste mësimore (para '90-ës), u konstatua një numër i madh fjalësh e kuptimesh të ideologjizuara, ku, çdo koncept i trajtuar, shoqërohet me një narrativë politike të qartë. P.sh., në “*Libri i gjuhës shqipe 5*”, 1980, me 220 faqe, fjalën “parti” e ndeshëm të përdorur në rreth 50 raste, me kuptime të politizuara në kontekstin e asaj periudhe. Ajo paraqitet me kuptim të lidhur ngushtë me Partinë e Punës së Shqipërisë, e cila ishte partia e vetme në pushtet dhe drejtonte vendin në mënyrë të centralizuar gjatë regjimit komunist. Po paraqesim disa shembuj të shkëputur nga ky tekst:

- *Parti, Enver, jemi gati kurdoherë!* (1980:3)
- *Sa thellë ke hyrë, Parti, në zemrat tona!* (1980:3)
- *Partia, shokë, na thërret.* (1980:7)
- *Ajo ishte një vajzë e vogël e Partisë.* (1980:7)
- *Të rrojë sa malet Partia!* (1977:4) (1980:7)
- *Nën udhëheqjen e Partisë, atdheu ynë po forcohet nga dita në ditë.* (1980:7)
- *Partia i ktheu fjalët në vepra.* (1980:7)
- *Shqipëria shkëlqen nga dritat e Partisë.* (1980:7)
- *Partia na prin nga fitorja në fitore.* (1980:29)
- *Partia përpiket për ngritjen e mirëqenies së popullit.* (1980:41)
- *Në emërtimet zyrtare të institucioneve të Partisë.* (1980:42)
- *Partia e Punës e Shqipërisë është organizuesja dhe frymëzuesja e të gjitha fitoreve të popullit tonë.* (1980:52)
- *Partia e Fronti Demokratik e kanë përdorur gjerësisht e me sukses aksionin.* (1980:54)
- *Partia jonë po bën një punë të madhe për formimin e njeriut të ri.* (1980:75)
- *Partia është forcë udhëheqëse e popullit tonë.* (1980:77)
- *Nuk pati ditë që të mos mblidheshin organizatat e partisë.* (1980:98)
- *Rruga e ndjekur nga populli e Partia ndërtimin e socializmit nuk ka qenë aspak një shesh me lule.* (1980:114)
- *Partia jonë ngriti lart me krenari e me një forcë të re flamurin e lavdishëm.* (1980:130)
- *Nën udhëheqjen e Partisë, populli ynë fitoi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.* (1980:136)
- *Partia na ngriti rrebeshe mbi tiranë.* (1980:140)

<sup>1</sup> F. Agalliu, A. Dodi, I. Dizdari. *Libri i gjuhës shqipe* (për klasën V), Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1973.

<sup>2</sup> F. Agalliu, A. Dodi, I. Dizdari. *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1977.

<sup>3</sup> F. Agalliu, A. Dodi, I. Dizdari. *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1979.

<sup>4</sup> F. Agalliu, A. Dodi, I. Dizdari. *Libri i gjuhës shqipe* (për klasën V), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1980.

<sup>5</sup> A. Dodi, E. Hysa, E. Gjylbegu, L. Bubani, S. Bobrati. *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1984.

<sup>6</sup> B. Beci, L. Bubani, Z. Gurabardhi. *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 2003.

<sup>7</sup> M. Gjokutaj, Sh. Rrokaj, L. Shuteriqi, T. Babasuli. *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 2022.

- *Partisë i shtrohej si detyrë një bashkëpunim i gjerë e i organizuar me ... (1980:146)*
- *Partia jonë kujdeset vazhdimisht për ngritjen e mirëqenies së masave punonjëse. (1980:146)*
- *Kemi Partinë ne, që na shikon në dritë të syrit. (1980:147)*
- *Të jeni të bindur se Partinë do ta keni kurdoherë afër. (1980:153)*
- *Partia dhe populli, të bashkuar si një trup i vetëm, bënë hi e pluhur sulmet e tërbuara të imperialistëve amerikanë. (1980:158)*
- *Vendimet e rëndësishme të Partisë kanë ngjallur në popull një frymë të lartë mobilizimi në punë. (1980:158)*
- *Formimi i njeriut të ri është vepra më e madhe e Partisë sonë. (1980:164)*
- *Partia këshillon vazhdimisht që i madh e i vogël të venë në shkollë. (1980:167)*
- *Erdhëm këtu, në ditët plot diell të Partisë sonë. (1980:169)*
- *Ata ndenjën deri natën vonë, ngritën dolli për Partinë, që solli këto ditë të lumtura. (1980:196)*
- *Të na prijë si kurdoherë në luftëra e në fitore flamuri i kuq i Partisë. (1980:219)*
- *Kemi popullin e Partinë, të edukuar me idetë e pavdekshme të mësuesve të mëdhenj të proletariatit botëror. (1980:219) etj.*

Siç dallohet nga këto raste, për shkak të ndikimit të fortë politik dhe kufizimit të pluralizmit, fjala “parti” nuk kishte kuptimin e zakonshëm shumëpartiak, por përfaqësonte kuptimisht komunizmin, si sistem monopartiak, me qëllim për të edukuar brezat në përputhje me normat e ideologjinë e tij. Referuar këtij konteksti, shfaqet edhe lidhja kuptimore me nocionet: “udhëheqje”, “orientim”, “besnikëri”, “ideal” ... ngarkuar në çdo rast me konotacionin politik të kohës.

Denduria e madhe në përdorim e fjalës “parti”, duke e kthyer atë në fjalë-kyç, brenda tekstesh që duhej të ishin mirëfilli shkencore, shfaqet deri tek *Ushtrimet*, si në rastet e mëposhtme:

**Ushtrimi 247.** Në vend të pikave vini nyjën që duhet.

**Partia** . . . Punës. . . Shqipërisë u themelua nga komunistët shqiptarë me shokun Enver Hoxha në krye. Historia ... **Partisë** ... Punës ... Shqipërisë është një thesar me një përvojë të madhe, që duhet studiuar vazhdimisht nga punonjësit ... vendit tonë.

Në të gjitha fushat ... jetës është vërtetuar drejtësia ... vijës politike ... **Partisë** sonë.

Nën udhëheqjen ... **Partisë** populli ynë fitoi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, rindërtoi vendin, ndërtoi bazën ekonomike ... socializmit dhe tani po marshon përpara për ndërtimin e plotë ... shoqërisë socialiste.

*Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I. Libri i gjuhës shqipe (për klasën V), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1980, f. 136-137.*

**Ushtrimi 336.** Gjeni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra. Tregoni trajtat e plota që u përgjigjen.

I vini pyetjen vetes kur bëni një punë: a është në interes të **Partisë** dhe të popullit? Në qoftë se është, luftoni ta çoni gjer në fund dhe, po t'ju dalin vështirësi gjatë rrugës, i vini gjoksin dhe i kapërceni. Në qoftë se diçka është në interesin e **Partisë**, dijeni se ajo është medoemos në interes të popullit, prandaj i bini malit dhe kapërcëjeni. Në qoftë se diçka që bëni, nuk është në

interesin e **Partisë**, ndërroni rrugën, që të mos jeni në vijë të gabuar. Me këtë prizëm të mësoheni t'i shihni çështjet, **Partia** pret shumë nga ju (E. Hoxha).

*Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I. Libri i gjuhës shqipe (për klasën V), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1980, f. 189.*

**Ushtrimi 96.** Lexoni fjalët fundore dhe tregoni ç'fjalë bëhen ato gjatë lakimit (nga vendi i theksit):

**parti, partisë, partinë;** liri, lirisë, lirinë; Shqipëri, Shqipërisë, Shqipërinë; re, resë, renë ...

*Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I. Libri i gjuhës shqipe (për klasën V), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1980, f. 50.*

Fjala “parti” në gjuhën shqipe, është ndër rastet me një strukturë kuptimore që ndryshoi ndjeshëm gjatë tranzicionit, duke reflektuar kështu realitetin dhe ndryshimet historike të Shqipërisë:

Në kontekstin e *para '90-ës*, semantika e fjalës “parti” nënkuptonte një ideologji të veçantë politike dhe pushtet absolut. Disa nga kuptimet e kësaj fjale në këtë periudhë përfshinin: *një forcë udhëheqëse* – që përfaqësonte ideologjinë komuniste; *një institucion shtetëror* – që barazohej me shtetin dhe organet e tij, për shkak se ishte e vetmja parti; dhe *sakrificë* – ku në kulturën e kohës, anëtarët e “partisë” konsideroheshin të përkushtuar ndaj një kauze të madhe që kërkonte sakrifica personale.

*Pas '90-ës*, me rënien e sistemit komunist dhe tranzicionin drejt demokracisë, fjala “parti” pësoi dukshëm ndryshim në strukturën e saj kuptimore, duke u bërë një term që përfaqësonte forca të ndryshme politike me ideologji të larmishme. Zhvillimet e saj kuptimore përfshijnë: *diversitetin politik* – ku filloi të përdorej për të përshkruar parti të ndryshme politike, me role të ndryshme në një sistem demokratik shumëpartiak; *kuptimin pluralist* – ku mori një karakter më neutral dhe pluralist, duke përfaqësuar mendime dhe ideologji të ndryshme. Me kalimin e viteve, fjala “parti” mori edhe një kuptim të ri, që lidhej me debatet politike dhe konkurrencën e lirë, ndërsa në kulturën popullore u bë e lidhur edhe me konceptet e demokracisë dhe zgjedhjeve.

Për të parë më qartë dallimin kuptimor të fjalës “parti” para e pas '90-ës, periudhë kur ndodhën ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore në Shqipëri, kemi paraqitur strukturën kuptimore të saj nga: *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (1980), në përqasje me *Fjalor i gjuhës shqipe* (2006):

**(Fjalor 1954)**

**Parti, -a**

**1.** *Organizatë politike që është pjesa udhëheqëse e një klase, mbron interesat e kësaj klase dhe udhëheq luftën e saj kundra klasave armike: Partia e Punës; Partia Komuniste; kabineti i*

*Partisë, institucion i organizatës së partisë, që merret me arësimin e partisë dhe është i pajisur me bibliotekë dhe sallë leximi.*

**(Fjalor 1980)**

**Parti, -a f. sh -(të)**

*1. Organizatë politike e një klase a e një shtrese shoqërore të caktuar, që ka programin e statutin e vet dhe që lufton për të mbrojtur interesat e klasës a të shtresës shoqërore, së cilës i përket. Parti politike. Parti borgjeze. Parti demokratike (konservatore, republikane). Parti fashiste. Parti revizioniste. Kongresi i Partisë.*

*2. Reparti pararojë dhe i organizuar i klasës punëtore, që e udhëheq atë drejt fitores së revolucionit proletar dhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste, që ka në themel të të gjithë veprimtarisë së saj idetë e marksizëm-leninizmit, lufton kundër armiqëve të klasës, kundër revizionizmit e rrymave të tjera oportuniste në gjirin e lëvizjes komuniste të vendeve të tjera, si edhe luftën e popujve të shtypur për çlirimin kombëtar. Parti komuniste. Parti marksiste-leniniste. Parti e tipit të ri. Parti e klasës punëtore. Partia e Punës e Shqipërisë (deri në vitin 1948 Partia Komuniste e Shqipërisë) reparti pararojë dhe i organizuar i klasës punëtore të Shqipërisë, forma më e lartë e organizimit të saj, që përbëhet nga revolucionarë të klasës punëtore në gjithë jetën politike, ekonomike, kulturore e ushtarake, që udhëhiqet në gjithë veprimtarinë e saj nga parimet e marksizëm-leninizmit, mbron interesat jetësore të popullit shqiptar, të socializimit e të revolucionit në shkallë kombëtare e ndërkombëtare dhe qëndron në ballë të luftës kundër revizionizmit modern e kundër të gjitha rrymave të tjera oportuniste në lëvizjen komuniste ndërkombëtare (shkurt: PPSH). Komiteti Qendror i PPSH. Kongresi i 7-të i PPSH.*

*3. Partia e Punës e Shqipërisë (deri në vitin 1948: Partia Komuniste e Shqipërisë). Populli dhe Partia. Anëtar partie. Tesera e Partisë. Organizata-bazë e Partisë. Kongresi i 7-të i Partisë. Komiteti i Partisë. Aktivi i Partisë. Mbledhje e partisë. Shkolla e Lartë e Partisë” V. I. Lenin”. Lidhja e Partisë me masat. Dhoma e Partisë. Kabineti i Partisë. Me frymë partie. Ç’thotë Partia bën populli. Kur hyri Partia. Bised. Kur u çlirua Shqipëria, pas 29 Nëntorit 1944.*

*4. vjet. Grup njerëzish që i bashkon përkohësisht një qëllim i caktuar; palë; secili nga grupet që marrin pjesë në një lojë. U ndanë dy partish. Partia e parë munda të dytën.*

**(Fjalor 2006)**

**Parti, -a f. sh -(të)**

*1. Organizatë politike e shtresave të caktuara shoqërore, që ka programin dhe statutin e vet.*

*2. Vjet. Grup njerëzish të bashkuar nga një qëllim; palë: u ndanë dy partish.*

Siç dallohet edhe nga kjo përjasje, struktura leksikore e fjalës “parti” paraqitet më e zgjeruar në *Fjalorin e 1980-ës*, me 4 kuptime, ku 3 të parët janë të politizuar. Në *Fjalorin e 2006-ës*, pas depolitizimit, kjo strukturë del e reduktuar në 2 kuptime, duke u ruajtur vetëm kuptimi i katërt nga Fjalori i 1980-ës.

Në tekstet e gjuhës shqipe, klasa V (1973-1984), **leksiku i politizuar** zë vend parësor e me frekuencë të lartë përdorimi. Ai përçon parimet, doktrinën dhe propagandën e regjimit komunist. Gjatë punës hulumtuese në këto tekste, veçuan disa leksema të tilla: *revolucionar, revizionist, imperialist, proletariat, revizionizëm, imperializëm, armik (i klasës, i popullit, i jashtëm) ...* Po

ashtu, me denduri në përdorim dallojnë fjalët *klasë* e *klasor*, të cilat u vunë re më së shumti si pjesë sintagmash me konotacionin e kohës: *klasë punëtore*, *klasë heroike*, *luftë klasore*, *klasë shfrytëzuese* etj., si në rastet: **Klasa** jonë **punëtore** është e re, ballëllartë e zemërtrime, se ka Partinë syshqiponjë, që di ta udhëheqë e ta vërë në rolin e saj pararojë. (1984:113); Nën udhëheqjen e Partisë, populli çliroi vendin dhe përmbysi **klasat shfrytëzuese**. (1984:44)...

Në tekstet e pas '90-ës, fjala "klasë" paraqitet në kuptimin e vendit ku zhvillohet mësimi dhe të grupit të nxënësve në një nivel të caktuar shkollimi, si: *Po bisedonim për zbulimin e klasës*. (2003:158); *Në këtë shkollë, në këtë klasë kemi shumë kujtime*. (2022:25); *Nxënësit e çdo klase ngritën stenden e tyre me librat e bibliotekës përkatëse*. (2022:26); *Në këtë panair, veç të tjerash, po njihemi edhe me nxënësit e klasave paralele*. (2022:26) ...

Nga tekstet mësimore të pas vitit '90, veçuam gjithashtu një grup fjalësh që më përpara rezultojnë me kuptim tjetër nga sot, në përputhje me kontekstin e kohës. Pra, dallimi i tyre qëndron në përdorimin kontekstual në periudhën respektive, si në rastet në vijim, me leksemat: *punë*, *histori*, *skuadër*, *rroj*, *veprimtari*, *klasë*, *top*, *çliroj*, *skuadër* etj.:

- ❖ Fjalën '**punë**' në tekstet e para '90-ës e ndeshim kryesisht në emërtimin e PPSH-së: *Partia e Punës e Shqipërisë është organizuesja dhe frymëzuesja e të gjitha fitoreve të popullit tonë*. (1984:34)  
*Ta doni atdheun tonë të shtrenjtë, Shqipërinë, ta doni popullin tonë, ta doni partinë tonë të Punës*. (1984:35)

Në tekstet e pas '90-ës, kjo fjalë paraqitet në kuptimin e një veprimtarie:

*Oh, punë e bukur. E kështu bënë. Por as kjo punë nuk u doli mirë, udhëtarët i qeshën përsëri e këtë herë edhe me fat duke i thënë se ish vepër e pashpirt dhe e turpshme ta mundonin ashtu atë shtazë të mjerë*. (2022:120)

- ❖ Fjala '**histori**' në tekstet e para '90-ës jepej e orientuar kryesisht nga ideologjia politike, për shkak të sistemit në fuqi dhe rolit të madh që luante propaganda: *Historia e Partisë e Punës së Shqipërisë është një thesar me një përvojë të madhe, që duhet studiuar vazhdimisht nga punonjësit ... e vendit tonë*. (1980:136)

Në tekstet e pas '90-ës kjo fjalë paraqitet në kuptimin e diçkaje që ka ndodhur ose që përsëritet; tregim ose përshkrim i një ngjarjeje; ndodhi:

*Gjyshi filloi t'u tregonte një histori*. (2003:185)

*Kujtime që vërshojnë teksa lexon histori si kjo e Tonit me gjyshin e vet apo teksta dëgjon shokët e shoqet të flasin për gjyshërit e tyre*. (2022:16)

- ❖ Fjala '**skuadër**' në tekstin e vitit 1980 paraqitet me kuptimin e një grupi të organizuar që vepron për realizimin e qëllimeve të sistemit: *Thuaji shokut Xhabir të dërgojë një skuadër partizane këtu...* (1980:192)

Në tekstet e pas '90-ës, ndeshet me kuptimin e një grupi lojtarësh që marrin pjesë në ndeshje:

*Si skuadra jonë, ashtu edhe ajo e "Besës" luanin mjaft mirë*. (2003:242)

*Skuadra jonë nuk shënoi gol*. (2003:265)

- ❖ Folja '**rroj**' në tekstin e vitit 1980 paraqitet në kontekst urimi, por me ngjyresë ideologjike politike:

*Të rrojë Partia! (1984:116)*  
*Të rrojë sa malet Partia! (1977:4) (1980:7)*  
*Rroftë brigada "Qemal Stafa"! (1984:120)*

Në tekstet e pas vitit '90, del vetëm në urimet e familjarëve:

*Rrofsh, o djalë! - tha teto Sava (2003:210)*  
*Ti nipçe, rrofsh shumë e shumë vjet pas meje! (2022:14)*

- ❖ Fjala '**veprimtari**' në tekstin e vitit 1980 shfaqet në një kontekst të tillë fryme totalitare:  
*Shoku Enver Hoxha filloi veprimtarinë e tij revolucionare ... (1984:90)*

Në tekstet e pas '90-ës, ndeshet me kuptimin e një aktiviteti:

*Këtë bindje na e përforcon edhe kjo veprimtari. (2022:26)*  
*Për veprimtarinë e saj në shërbim të njerëzimit u nderua me çmimin Nobel për paqen. (2022:187)*

- ❖ Fjala '**top**' në tekstet e para '90-ës jepej edhe me kuptimin e një arme të rëndë zjarri me grykë të gjatë, që i hedh predhat larg:  
*...ne i kemi në grykën e topit (1977:100) (1979:98)*  
*Këshjtjella gjëmoi me të tridhjetë e pesë topat e saj. (1984:109)*

Në tekstet e pas '90-ës kjo fjalë paraqitet në kuptimin e një rruzulli llastiku, që përdoret për të luajtur:

*Topin e mori skuadra jonë. (2003:181)*  
*Topi i fryrë me ajër u përdor në vitet 659-707 të erës sonë. (2003:242)*

- ❖ Fjala '**çliroj**' në tekstet e para '90-ës jepej në kontekstin e "lirisë":  
*U përpoqa me gjithë fuqitë e mia për çlirimin e atdheut tonë të dashur. (1984:21)*

Në tekstet e pas '90-ës kjo fjalë paraqitet në kuptimin e të vepruarit lirisht; shpëtimi nga diçka e padëshirueshme:

*U çlirova pak. (2022:32)*  
*I çliroi me vështirësi.... (2022:79)*

Nga viti 1990 e këndej pati lëvizje të mëdha në leksikun e shqipes, për shkak të ndryshimeve të thella politike për Shqipërinë. Shumë fjalë të lidhura me koncepte të periudhës së komunizmit dolën nga përdorimi i gjallë, të tjera fjalë që lidhen me sistemin e ri politiko-shoqëror, hynë në përdorim. Si rezultat i këtyre lëvizjeve që pësoi leksiku i shqipes, si element të rëndësishëm veçojmë rikthimin në përdorim të disa fjalëve që u larguan bashkë me konceptin gjatë kohës diktatoriale, të tilla si: *bashki, prefekturë, komunë, kuvend* etj., për t'u rikthyer me kuptimin e tyre të plotë pas '90-ës.

Jo të pakta rezultuan edhe rastet me dalje nga përdorimi gjatë periudhës së komunizmit e rikthim përsëri (pas komunizmit) të njërit prej kuptimeve të strukturës semantike të fjalës. Si rast të tillë kemi veçuar fjalën '*shok*', me përdorim të dendur në librat në shqyrtim, si: Në tekstin *Gjuha shqipe V* (1973) fjalën "*shok*" e ndeshëm në 106 raste e në *Gjuha shqipe V* (1980) në 89 raste, pothuajse të gjitha të ideologjizuara.

Referuar *Fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe*, fjala "*shok*" paraqitet me këtë lëvizje kuptimore në rrjedhën e viteve, para e pas '90-ës, si në vijim:

Në "Fjalor i gjuhës shqipe" (1954), emri "*shok*" shfaqet me dy kuptime:

1. Ai që shkon mirë me një tjetër, që ka miqësi dhe është i së njëjtës moshë me të; ai që ka të përbashkët me tjetrin shkollën, punën etj.;
2. Person i vështruar si anëtar i një kolektivi, njeri i rrethit tonë; shoq; fem. shoqe.<sup>8</sup>

Në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” (1980), emri “shok” paraqitet me një strukturë semantike të zgjeruar, me 9 kuptime, ku kuptimi i pestë, i politizuar, perifrazohet si më poshtë:

“Anëtar i Partisë së Punës të Republikës, anëtar i organizatave të masave në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, anëtar i një partie a i një organizate marksiste-leniniste; pjesëtar i një kolektivi punonjës në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë a shtetas i saj; fjalë që përdorim përpara emrit të plotë ose vetëm përpara emrit a mbiemrit të udhëheqësve të Partisë e të Shtetit, të anëtarëve të Partisë e të organizatave të masave, të punonjësve që kryejnë detyra shtetërore e shoqërore dhe të pjesëtarëve të tjerë të kolektivave punonjëse, të cilëve u drejtohem me nderim a zyrtarisht; fjalë që përdorim përpara emrave të përgjithshëm a të veçantë të punonjësve, kur flasim zyrtarisht për ta. Shoku Enver. Shok i vendosur (i ngritur, i përgatitur). Shok i vjetër (i ri). Shok partie. Shokët e Partisë (e Rinisë, e Bashkimeve Profesionale). Shokët e partive komuniste marksiste-leniniste. Shokët e byrosë. Shokët përgjegjës. Shokët punëtorë (kooperativistë). Shokët e bazës (e qendrës). Diskutimet e shokëve. Erdhi një shok nga qyteti (nga fshati). Të dashur shokë! Shoku qytetar! Shoku inxhinier! Shoku oficer! Shoku ushtar! Shok, kalo djathtas! Pa dëgjoni, more shokë!” (Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 1883).

Përgjatë periudhës së komunizmit, fjala “shok” u përdor kryesisht me këtë kuptim, duke zëvendësuar fjalën *zotni*. E tillë rezultoi kuptimisht kjo fjalë edhe në tekstin “Libri i gjuhës shqipe V”, 1980, nga ku veçuan disa raste për ilustrim:

*Partia, shokë, na thërret. (1980:7)*

*Na ike, shoku Kadri, foli i mallëngjyer kryetari i këshillit. (1980:11)*

*Shoku drejtor, njihiu me babanë tim. (1980:15)*

*Të udhëhequr nga Partia jonë e dashur dhe mësuesi ynë, shoku Enver, ne po ndërtojmë socializmin në vendin tonë ashtu si ëndërrove ti. (1980:17)*

*Përpara, shokë! (1980:113)*

*Partia e Punës e Shqipërisë u themelua nga komunistët shqiptarë me shokun Enver Hoxha në krye. (1980:136)*

*Fshati ynë ka qenë i gjithë partizan, shoku kryetar. (1980:183)*

*Ju, shoku drejtor, më thirrët? (1980:183)*

*Thuaji shokut Xhabir të dërgojë një skuadër partizane këtu ... (1980:192) etj.*

Pas ’90-ës, ky kuptim ka rënë, duke u rikthyer fjala *zotni*, që ka ndjekur historikisht një rrugë në drejtim të kundërt me fjalën ‘shok’. Duket sikur këto dy fjalë, për shkak të ngjyrymeve sociale e politike, kanë qenë në konkurrencë. Në “Fjalor i gjuhës shqipe” (2006), kuptimi i politizuar është larguar nga struktura kuptimore e kësaj fjale pas çlirimit nga ideologjizimi komunist që iu bë fjalësit të tij. Ky depolitizim do të përshkonte njëkohësisht edhe tekstet mësimore, ku, nga *Gjuha shqipe V* (2003 e 2022) shkëputëm disa prej përdorimeve të kësaj fjale:

*Trimat nuk e njohin më shoku - shokun. (2003:42)*

*Do të ikja, por më vinte turp nga shokët. (2003:26)*

*U mërzita shumë, sepse ai ishte shoku im më i mirë. (2022:14)*

*Ne të dy shkonim shumë mirë me njëri – tjetrin dhe luanim së bashku si dy shokë. (2022:14)*

*Sigurisht që jo, - iu përgjij ajo: S’të gjendet shoku. (2022:10)*

<sup>8</sup> K. Cipo, E. Çabej, M. Domi, A. Krajni, O. Myderrizi. *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954, f. 533.

Në fjalorin e Aleksandër Xhuvanit, “Fjalori i gjuhës shqipe” (2020), lënda e të cilit është mbledhur kryesisht nga fjalorë të viteve 1908 e 1941 dhe prej veprave të autorëve të vjetër<sup>9</sup>, fjala “shok” nuk shpjegohet me përkufizim, por ilustron menjëherë me shembuj, të cilët i referohen kuptimeve të mësipërme: “*Shok i pandarë; shok për kokë, fr. un ami à toute épreuve, njeri pa shok në jetë; Skënderbeu nuk ka shok në trimërit, në diturit të luftësë (S. Frashëri); të shofim cili do të bëjë shokë (do të lidhi shoqëri); ishin mbledhur aty **shoj mbi shoq.***”<sup>10</sup>

Me ardhjen e demokracisë, shumë fjalë e kuptime që ishin të zakonshme deri në atë kohë në tekstet mësimore, u lanë mënjanë, pasi ndryshimet politike, kulturore dhe sociale sollën një riorganizim të gjuhës në përputhje me kontekstin e ri. Shumë prej tyre dolën nga përdorimi bashkë me realien që emërtonin. Le të veçojmë disa raste prej këtij grupimi: **agjikator** (... *agjitatore e flaktë e mësimore të Partisë.*) (1984:259); **antitanks** (... *kur shtie antitanksi yt, gjermanët dridhen.*) (1977:16); **artelier** (*Artelierët premtajnë se do të jenë kurdoherë të gatshëm ...*) (1979:98); **bomba** (*Me bomba dore qëllonin ballistët nga dritaret e shtëpive.*) (1984:117); **brigadë** (*Rroftë brigada “Qemal Stafa”!*) (1984:120); **çetë** (*Ishte partizani më i ri i çetës.*) (1977:14); **dyfek** (*Krisën dyqind dyfekë dhe fluturuan shigjetat.*) (1984:109); **fashist** (*Fashistët italianë kishin thyer qafën nja gjashtë muaj më parë.*) (1984:76); **fashizëm** (*Pas kaq luftërash heroike heroike kundër fashizmit.*) (1977:158); **gjyle** (*Tutkun, ti harrove gjylet!*) (1984:183); **imperializëm** (*Stuhia e luftës revolucionare kundër imperializmit.*) (1977:14); **partizan** (*Partizanët luftojnë me guxim.*) (1979:6); **pionier** (*Në qafë i flakëronte shall i pionierit.*) (1984:3); **predhë** (... *do të asgjësojmë objektivin me predhën e parë!*) (1977:100); **revisionist** (*Stuhia e luftës revolucionare kundër imperializmit dhe revizionizmit është në ngritje.*) (1984:120); **tank** (*Tanket vinin vërdallë ulurinë e shtinin.*) (1977:9); **traktat** (*Bashkë ngjithim traktate me shkronjat PKSH.*) (1984:107)...

Kështu, nëse në tekstet në shqyrtim të para ’90-ës ishin të pranishme fjalët: *antitanks, tank, tankist, agjikator, artelier, çetë, ballist, fashist, fashizëm, kooperativë, kooperativist, brigadë, brigadier, revisionist, pionier, parullë, traktat* etj.; në tekstet e pas ’90-ës nuk ndeshen më, duke kaluar në shtresën pasive të leksikut të shqipes, shumë prej tyre si *historizma*.

Sa i përket kategorisë leksiko-gramatikore, bie në sy dominimi i leksemave emërore, ndjekur nga ato mbiemërore e më pak ato foljore. P.sh., **emërore**: *antitanks* (1979:16), *armë* (1984:117), *armik* (1973:25), *artelier* (1984:105), *automatik* (1977:122), *barbarë* (1984:187), *betejë* (1984:184), *bombë* (1984:117), *bombardime* (1984:118), *dëshmor* (1984:23), *dyfek* (1984:109), *gjak* (1984:24), *gjyle* (1984:183), *hero* (1973:172), *llahtari* (1977:124), *luftë* (1984:39), *mitraloz* (1977:124), *okupator* (1977:167), *predhë* (1984:105), *pushkë* (1977:100), *sulm* (1977:113), *tank* (1984:227), *tankist* (1984:195), *top* (1984:109), *tradhëtar* (1984:117) etj.; **mbiemërore**: *armatosur (i, e)* (1977:167), *barbar* (1977:154), *heroik* (1973:94), *luftarak* (1984:107), *revizionist* (1977:55) etj.; **foljore**: *asgjësoj* (1979:98), *bombardohen* (1977:150), *u thyen* (1973:168) etj.

Ndërsa gjatë periudhës së komunizmit, nxënësit, përmes tekstit të gjuhës shqipe, mësonin fjalë të tilla që shprehnin ashpërsi, urrejtje dhe agresivitet, sot, ky leksik i vrazhdë i asaj periudhe nuk është më i pranishëm në tekstet mësimore. Duke qenë të detyruar ta mësonin gjuhën amtare

<sup>9</sup> Aleksandër Xhuvani iu referua fjalorëve: Fjaluer i Rii i Shcypes, 1908, i Shoqërisë “Bashkimi”; Fjalorth i Ri, 1941, i N. Gazullit; Fjalorth i Ri, 1941, i P. Tases; Fjalori i Gjuhës Shqipe, 1954 etj., si dhe veprave të autorëve të vjetër (Buzuku, Budi, Bogdani, Bardhi). (Engjëllushe Karaj, *Parathënie*, në: Aleksandër Xhuvani, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2020, f. VII.)

<sup>10</sup> Aleksandër Xhuvani. *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2020, f. 593.

me këtë leksik, krijohej tek ata një shprehi e mbushur me revolta dhe larg botës së tyre feminare, e aq më tepër larg shprehive me imagjinatë e kreativitet.

*Leksiku i ideologjizuar* me përdorim specifik në kontekstin e kohës, pothuajse e humbi përdorimin pas vitit '90 për shkak të ndryshimeve politike e shoqërore, duke u zëvendësuar me leksik asnjans a duke humbur funksionin e tij në diskursin publik dhe arsimor. Me fillimin e periudhës së demokratizimit në Shqipëri, shumë nga këto fjalë apo kuptime të veçanta të tyre dolën nga përdorimi i zakonshëm, në disa raste bashkë edhe me realien që emërtonin. Si i tillë, sot ky leksik përdoret kryesisht në kontekste historike e me vlerë evokuese.

Në mbyllje, pohojmë që leksiku i ngarkuar me konotacionin ideologjik të para '90-ës në Shqipëri, ishte një produkt i drejtpërdrejtë i sistemit politik të kohës që diktonte gjuhën dhe narrativën sipas parimeve të një regjimi të egër diktatorial. Pas '90-ës, me kalimin drejt sistemit demokratik, leksiku pësoi transformime të thella; elementet totalitare u zëvendësuan me terma të lidhur me pluralizmin e globalizmin, duke pasqyruar dinamika kulturore dhe shoqërore.

Kjo përjasje leksiku përmes teksteve mësimore të këtyre dy periudhave të historisë shqiptare dëshmon qartë se gjuha është një pasqyrë e fuqishme e realitetit shoqëror, ku ndryshimet në sistemet politike shoqërohen me ndryshime të dukshme në përdorimin dhe zhvillimin e saj. Kështu, përmbajtja e teksteve nuk është thjesht një reflektim i ndryshimeve gjuhësore, por edhe një pasqyrim i zhvillimeve politike, sociale dhe kulturore.

## BIBLIOGRAFI

- **Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I.**, (1973). *Libri i gjuhës shqipe* (për klasën V), Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë.
- **Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I.**, (1977). *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë.
- **Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I.**, (1979). *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë.
- **Agalliu, F.; Dodi, A.; Dizdari, I.**, (1980). *Libri i gjuhës shqipe* (për klasën V), Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë.
- **Dodi, A.; Hysa, E.; Gjylbegu, E; Bubani, L.; Bobrati, S.**, (1984). *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë.
- **Beci, B.; Bubani, L.; Gurabardhi, Z.**, (2003). *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë.
- **Gjokutaj, M.; Rrokaj, Sh.; Shuteriqi, L.; Babasuli, T.**, (2022). *Gjuha shqipe 5*, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë.
- **Cipo, K.; Çabej, E.; Domi, M.; Krajni, A.; Myderrizi, O.**, (1954). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- **Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë**, (1980). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- **Akademia e Shkencave e Shqipërisë**, (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- **Xhuvani, A.**, (2020). *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- **Gjokutaj, M.**, (2009, 2012). *Didaktikë e gjuhës shqipe*, ShBLU, Tiranë.
- **Gjokutaj, M.; Hoti, I.**, (2014). *Çështje të trajtimit të gjuhësisë së zbatuar para dhe pas viteve '90 në gjuhësinë shqiptare*, Prishtinë.
- **Baja, O.**, (2018). *Contemporary teaching methodologies: science and art*, “Knowledge”, Vol. 23, Nr. 1, Skopje.
- **Thomaj, J.**, (2020). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- **Rama, B.**, (2015). *Kurrikula e gjuhës shqipe dhe e letërsisë në kontekst bashkëkohor*, EMAL, Tiranë.